

Turqia u radhit në vendin e 15 të vendeve me ekonominë më të madhe në botë.

Ministri turk i Ekonomisë, Nihat Zejbekçi, deklaroi se Turqia sipas paritetit të fuqisë blerëse radhitet në vendin e 15-të të vendeve me ekonominë më të madhe në botë.

Ministri Zejbekçi gjithashtu tha se edhe objektivat për rritje do të përmbushen deri në fund të vitit.

Duke bërë të ditur se ata, të cilët objektivat e rritjes së Turqisë i kanë vlerësuar si të ulëta, pasi të kuptojnë se kanë gabuar do të jenë të detyruar që në korrik të bëjnë vlerësimin e kundërt, Ministri Zejbekçi tha se Turqia këtë vit do ta mbyllë me një nivel më të lartë të rritjes se sa është parashikuar./trt/